

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e katërbëdhjetë, deri më 07.04.2024)

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së katërbëdhjetë të vitit 2024 (nga 01-07.04.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 153 ($I=8,3/100.000$) të prekur nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 6,1% më pak krahasuar me javën e kaluar ($n=163$).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit të kaluar ($n=143$) është regjistruar një rritje prej 7,0%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit ($n=203$) është regjistruar një rënie prej 24,7% (*Grafiku 1*).

Gjatë javës së katërbëdhjetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV kanë arritur 25 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 2 raste kanë rezultuar pozitive me Influenza B/Victoria.

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit ($I=30,6/100.000$) (*Grafiku 1*).


***Grafiku 1.** Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024*



Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e katërbëdhjetë 2024

Sa i përket shpërndarje grupmoshën e cila për incidencë më e lartë (1.8%)


Grafiku 3. Shpërndarja



Shpërndarja e sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 1,3%
- nëntor – 268 raste ose 1,8%
- dhjetor – 829 raste ose 5,7%
- janar – 5.176 raste ose 39,0%
- shkurt – 6.373 raste ose 43,5%
- mars – 1.108 raste ose 7,6%,
- prill (do 07.04.2024) – 153 raste ose 0,1%.

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezoni 2023/2024



rasteve të gripit

raste ose

Deri më tani gjatë këtij sezoni, Kumanova, Negotina, Gostivar dhe Struga janë të gjithë të hospitalizuar dhe të vdekur. Është vërtetuar Influenza B/Victoria.



МБИКЌЫРЈА ВИРОЛОГИЈЕ (mbikëqyrja rutinore) – Тë dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e katërbëdhjetë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.001 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 156 raste pozitive, 118 Influenza A(H1)pdm09, 12 Influenza A(H3) dhe 11 Influenza A – e pasubtipizuar, 14 Influenza B/Victoria dhe 1 Influenza B –linjë e papërcaktuar. Janë regjistruar edhe 20 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

МБИКЌЫРЈА SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së katërbëdhjetë janë raportuar gjithsej 33 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga KSIGJF (n=11; 33,3%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=9; 27,3%) janë raportuar në mesin e grupmoshës mbi 65 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 220, pa raste në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 15,0% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 44,4% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së katërmbëdhjetë për analizë laboratorike kanë arritur 27 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në mostrat e analizuara në 2 mostra është vërtetuar Influenza B – e papërcaktuar. Në asnjë mostër është vërtetuar COVID-19, 24 mostra janë testuar për virusin sincicial respirator, pa raste pozitive.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 1.099 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=347; 31,6%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=462; 42,7%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 5.373, nga të cilët 54 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 20,5% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 38,4% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 14 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09, Influenza A e pasubtipizuar dhe Influenza B/Victoria, ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 682 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 79 mostra është vërtetuar Influenza A(H1) pdm09, në 23 Influenza B/Victoria, në 18 Influenza A(H3), në 6 Influenza A – e pasubtipizuar dhe në 4 mostra Influenza B – linja e papërcaktuar. Janë regjistruar 38 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 484 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 116 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 3 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE – të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e katërmbëdhjetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 1.565 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.

Janë zbuluar 286 raste me Influenza:

- Influenza A – 244 (85,3%)
 - Influenza A(H1)pdm09 – 197 (80,7%)
 - Influenza A(H3) – 30 (12,3%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar - 17 (7,0%)
- Influenza B – 42 (14,7%)
 - Influenza B/Victoria – 37 (88,1%)
 - Influenza B – linja e papërcaktuar – 5 (11,9%)


Janë regjistruar 58 raste pozitive me SARS-CoV-2, 145 me (RSV) dhe 13 me viruse të tjerë respiratorë. Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 6 raste është vërtetuar infeksion i dyfishtë (“flurona”).

Grafiku 5. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024

KOMENT EPIDEMIOLOG

Vihet re një stabilizim i jashtë-sezonal. Rezultat influencës, ndërsa përc numri i personave të dhënave, Republika e M aktivitetit të virusit të g

VAKSINIMI KUNDËR GRI



Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale.

Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 59.182 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.643 persona.

Deri në javën e tetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.825 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e njëmbëdhjetë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 12 nga 31 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit mbetet i shpërndarë gjerësisht, por po shënon një rënie të vazhdueshme. Aktiviteti i COVID-19 ka rënë këto muajt e fundit.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV në 3 muajt e fundit po shënojnë një rënie të vazhdueshme.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza B (73%) – të gjitha linjat dhe Influenza B/Victoria (n=52).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është 6% krahasuar me 7% një javë më parë.
- SARS-CoV-2 është në 2% krahasuar me 2% javën e kaluar.
- RSV ishte 3% krahasuar me 5% në javën e kaluar.

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet të lartë të virusit të gripit, 8 kanë raportuar intensitet mesatar, 16 të ulët dhe 12 të tjerat intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 20 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 7 - rajonale, 3 – lokal, 9 – sporadike, ndërsa 2 vende nuk kanë regjistruar aktivitet të virusit të gripit.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Institutin e Shëndetit Publik

